

VENDIM

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"TIMAC" SHPK;

Sot më datë 23.08.2022, ora 10.00 mbahet mbledhja e Asamblesë e Ortakëve të Shoqërisë Timac shpk, mbledhja është thirrur sipas Statutit të Shoqërisë.

Mbledhja drejtohet nga Administratori dhe njëkohësisht ortaku i vetëm i shoqërisë "TIMAC" shpk, zj.Eneida Puca, dhe që zotëron 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë. Pas diskutimesh, në zbatim të nenit 73 e 74 të ligjit nr.9901 datë "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të statutit të shoqërisë, Asambleja e Ortakëve vendosi:

- Shitjes e kuotës së ortakut të vetëm të shoqërisë zj.Eneida Puca e që përfaqëson 100 % të kapitalit, nëpërmjet kontratës së shitjes në favor të blerësit zj.Eneida Puca për vlerën prej 100 000 Lekë;
- Miratimin e kontratës së shitjes së kuotave të dates 23.08.2022 nga zj.Eneida Puca në favor të zj.Arjeta Puca;
- Ky vendim se bashku me kontratën e shitblerjes së kuotave të shoqërisë depozitohen në QKB, sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregëtare;

Në përfundim, mbledhja deklarohet e mbyllur.

Për ortakun e vetëm të shoqërisë

Zj.Eneida Puca



KONTRATË SHITJEJE E KUOTAVE

Sot më datë 23/08/2022, nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotës së kapitalit mes palëve të mëposhtme:

Shitësi: Zj. Eneida Puca, e bija e Shpetimit, e datëlindjes 18.06.1985, lindur në Bulqizë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër personal I55618093L, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr.2438 Repertori 747 Koleksioni, datë 29.04.2022, nga Arjeta Puca, e bija e Shpëtimit, e datëlindjes 01.03.1987, lindur në Zerqan dhe banuese ne Tiranë, me nr.personal I75301107J, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Shitësi";

Blerësi Zj. Arjeta Puca, e bija e Shpëtimit, e datëlindjes 01.03.1987, lindur në Zerqan dhe banuese ne Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar me nr.personal I75301107J, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Blerësi";

Personat e mësipërm me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë Kontratë Shitjeje të Kuotave të Kapitalit, sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:



Shoqëria "Timac" sh.p.k., person juridik shqiptar, është një subjekt tregtar, i themeluar në vitin 2020, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT M01706003U, me seli në Tiranë, në adresën Tirana Industrial Park", Nr. 37, Rruga Egnatia, me Administrator zj.Eneida Puca, me kapital të shoqërisë në 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë, e ndarë në 1 (një) kuotë, me ortak të vetëm zl Eneida Puca, e cila zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Shitësi me vullnet të lirë dhe të plotë i shet blerësit kuotën e tij në shoqëri me përqindje të pjesmarrjes 100 %, me vlerë 100 000 Lekë.

Blerësi deklaron se është dakord të blejë nga shitësi kuotën e tij më shoqëri me përqindje të pjesmarrjes 100 %, me vlerë 100 000 Lekë.

Shitësi garanton Blerësin, se kuota objekt kontrate, nuk është objekt pengu dhe është e lirë nga çdo lloj titulli e natyre ndaj të tretëve.

Me nënshkrimin e kontratës pala shitëse largohet nga shoqëria dhe ortak i saj mbetet pala blerëse me 1 kuotë me përqindje të pjesmarrjes 100 %.



Vlera e shitjes së kuotës është likujduar plotësisht nga blerësi në favor të shitësit.

Blerësi merr përsipër cdo detyrim të mëparshëm të shoqërisë si edhe të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktiviteti i shoqërisë në të ardhmen.

Kjo Marreveshje nuk mund te ndryshohet, modifikohet ne ndonje menyre tjeter, pervecse me shkrim, e nenshkruar nga Palet e kesaj Marreveshje.

Kjo kontratë hartohet në 3 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde nga ose ne lidhje me kete Marreveshje, do te zgjidhet me mirekuptim nga Palet, ne te kunderten, palët mund ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI
ENEIDA PUCA



BLERËSI
ARJETA PUCA